

Shkatërrohet banda që vidhte në banesa, 5 të arrestuar

Publikuar më: 11:45 • 13 Prill 2021 • Përditësimi i fundit 13:14 • 13 Prill 2021



Policia ka njoftuar arrestimin e 5 personave, pjesëtarë të një bande që vidhte nëpër banesa, që dyshohet se kanë kryer vjedhje edhe në vende të Bashkimit Evropian.

Në pranga kanë rënë Dorjan Lamani (Qirjazi), 38 vjeç, banues në Sarandë, i dënua më parë për "Kultivim të bimëve narkotike"; Klodian Çypri, 34 vjeç, banues në Derven, Fushë Krujë, i dënua më parë për "Kultivim të bimëve narkotike"; Halil Topalli, 29 vjeç, banues në Tapizë, Fushë Krujë, i dënua më parë për "Kanosja" dhe "Kundërshtimi i punonjësve të Policisë"; Redian Begaj, 32 vjeç, banues në Vlorë, i dënua më parë për "Heqja e paligjshme e lirisë" dhe "Moskallëzim krimi"; Dajvid Dosti, 21 vjeç, banues në Poliçan, Skrapar.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në datën 12.04.2021, janë kapur në flagrancë menjëherë pas kryerjes së vjedhjes së banesës së shtetases B. S., te kompleksi i vilave pas qendrës tregtare "TEG", ku kanë marrë një shumë të konsiderueshme në euro, bizhuteri dhe sende të tjera me vlerë.

Njoftimi i plotë i policisë:

Finalizohet me sukses operacioni policor "START & STOP".

Goditet një grup i strukturuar kriminal që ushtronte veprimtari kriminale në fushën e vjedhjes së pronës.

Vihen në pranga 5 pjesëtarë të grupit kriminal, persona me precedent të theksuar kriminal në fushën e vjedhjes së pronës.

Ky grup dyshohet të ketë kryer veprimtari kriminale edhe në disa vende të BE-së.

Sekuestrohen armë zjarri, vlera monetare, bizhuteri, radio marrëse-dhënëse si ato të Policisë, telefona celular dhe prova të tjera materiale.

Pas një pune policore dhe procedurale të pandërprerë prej disa muajsh, nga Sektori për Hetimin e Krimeve të Rënda Ndaj Jetës dhe Pronës, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale në DVP Tiranë, me mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është finalizuar me sukses operacioni policor i koduar "START & STOP", në kuadër të të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

Dorjan Lamani (Qirjazi), 38 vjeç, banues në Sarandë, i dënua më parë për "Kultivim të bimëve narkotike";

Klodian Çypri, 34 vjeç, banues në Derven, Fushë Krujë, i dënua më parë për "Kultivim të bimëve narkotike";

Halil Topalli, 29 vjeç, banues në Tapizë, Fushë Krujë, i dënua më parë për "Kanosja" dhe "Kundërshtimi i punonjësve të Policisë";

Redian Begaj, 32 vjeç, banues në Vlorë, i dënua më parë për "Heqja e paligjshme e lirisë" dhe "Moskallëzim krimi";

Dajvid Dosti, 21 vjeç, banues në Poliçan, Skrapar.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në datën 12.04.2021, janë kapur në flagrancë menjëherë pas kryerjes së vjedhjes së banesës së shtetases B. S., të kompleksi i vilave pas qendrës tregtare "TEG", ku kanë marrë një shumë të konsiderueshme në euro, bizhuteri dhe sende të tjera me vlerë.

Nga grupi hetimor i ngritur posaçërisht për hetimin e kësaj ngjarjeje janë sekuestruar prova materiale si armë zjarri, vlera monetare, bizhuteri, radio marrëse-dhënëse si ato të Policisë dhe telefona celular, konkretisht:

- 1 armë zjarri automatik, me dy krehër dhe 123 fishekë;
- 17.150 euro, 2 radio marrëse-dhënëse si ato që përdor Policia e Shtetit,
- Bizhuteri të ndryshme floriri, si unaza, vathë, ora dore, varëse, medalionë etj,
- 3 palë çelësa automjetesh, njëri prej të cilit dyshohet të jetë vjedhur në banesën e shtetasit A. N., ngjarje e ndodhur në datën 14.12.2020,
- 1 automjet tip "Ford", si dhe pajisje të tjera që shërbejnë për hapjen e bravave dhe dyerve të blinduara.

Nga puna e bërë deri tani rezultojnë se këta shtetas, në bashkëpunim edhe me shtetas të tjerë, janë autor të dyshuar dhe të vjedhjes së banesës së shtetasit A. N., në rrugën "Xhanfize Keko", ngjarje e ndodhur në datën 14.12.2020, ku janë vjedhur 40.000 lekë dhe automjeti i tij.

Gjithashtu nga hetimet e deritanishme rezultojnë se këta shtetas, pasi siguronin informacione dhe piketonin banesa ku kishte shuma parash dhe bizhuteri, organizonin dhe kryenin vjedhjen e tyre.

Nën drejtimin e Prokurorisë vijon puna për dokumentimin dhe zbardhjen e ngjarjeve të tjera në të cilat mund të jenë të përfshirë këta shtetas.

Nëpërmjet Interpol Tiranës po bashkëpunohet edhe me disa vende të BE-së, për të dokumentuar aktivitetin kriminal të këtyre personave në Greqi dhe vende të tjera të BE-së.

Materialet në ngarkim të shtetasve të mësipërm i dërgohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Vjedhje me pasoja të rënda" e kryer në bashkëpunim "Sigurimi i mjeteve për vjedhje", "Mbatja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe e municionit" dhe "Grupi i strukturuar kriminal".

Facebook @A2CNN në Facebook

YouTube A2 CNN në YouTube

Instagram @a2_news në Instagram

Twitter @a2_news në Twitter

Kronikë



Aksident me katër të plagosur në Shkodër-Lezhë

Dëshmia e Enver Jamakut: Më premtuan 300 mijë euro për vrasjen e Domart Konjarit

Aksident tragjik në Gjakovë, 3 të vdekur, dyshohet se viktimat janë nga Shqipëria

Plagosja e 33-vjeçarit në Fier, policia zbardh ngjarjen dhe arreston 3 persona

Gjendet kufoma e një të riu në lumin Shkumbin

Të fundit



Spektatorët rrahin arbitrin në ndeshjen e basketbollit për femra

Donald Trump, një baba shembullor, i mëson të birit golfin

Përkeqësohet shëndeti i Navalny, zëdhënësja e tij: Po vdes, është çështje ditësh

"500 patronazhistë kam unë", Meta: Do vij me prova për "Gestapon" e kohëve moderne

"Patronazhistët janë fuksa", Meta: Vota është e shenjtë, mos pranoni nënshtrimin për një shpërblesë momentale

SHQIPËRIA

- Aktualitet
- Ekonomi
- Kronikë
- Politikë
- Sociale

RAJONI DHE BOTA

- Kosova
- Ballkani
- Bota

EMISIONE

- Absolut 4
- A2 Business
- Dita jonë

ARGËTIM

- Showbiz
- Lifestyle
- VIDEO Argëtim
- FOTOGALERI
- Teknologji

VIDEO

- Shqipëria
- Politikë
- Bota
- Argëtim
- Sport

SPORT

- Futboll
- Sporte të tjera
- FOTOGALERI SPORT
- VIDEO Sport

Kryesore

- Rreth A2 CNN
- Frekuenca
- Karriera
- Kontakt